

**koha e lirë**

**vajzat dhe djemtë**

**lojëra, sport,  
natyrë, muzikë**

**organizata më  
e madhe rinore në Zvi-  
cër**

**të jesh i lidhur  
me tërë me tërë botën**

**lidhni shoqëri**

**përjeto aventurën**


battasendas

freundlicherweise zur Verfügung gestellt durch

pfadiluzern



mit freundlicher Unterstützung durch



Fachstelle für Rassismusbekämpfung FRB



Kompetenzzentrum  
interkulturelle Öffnung SAJV

**Mirë se vini**

Të jesh bashkëpjesëmarrës në Pfadi është fare thjeshtë, të gjithë fëmijët dhe të rinjtë tek ne janë të mirëseardhur për të "nuhatur".

**Ende keni pyetje?**

Udhëheqëset dhe udhëheqësit e degëve lokale të Pfadi-t do t'ju tregojnë me dëshirë edhe më tepër për Pfadi-n dhe programin e tyre dhe nëse ka pyetje dhe pyetje do t'ju ndihmojnë.

Kontaktadresse:

albanisch

battasendas

[Skauts]

kush jemi ne, çfarë bëjmë ne





## Skaut (Pfadi)...

..ka më shumë se 19'000 vajza dhe 23'000 djem, është organizata më e madhe rinore në Zvicër.

..është e pavarur politikisht dhe e pavarur nga religjioni.

..në tërë botën ka më shumë se 40 milion anëtarë, në mbi 160 shtete.

..mund ta gjeni kudo, ku fëmijët banojnë: në shumë komuna, në fshatra dhe në qytet.

## Qëllimet tona

Pfadi domethënë përjetime, shoqëri të paharrueshme dhe argëtim të mirë.

Fëmijët njëkohësisht mësojnë

- të marrin përgjegjësi për vete dhe për të tjerët.
- të jenë të hapur, dhe në grup të kenë kujdes dhe respekt.
- kohën e tyre të lirë vetë ta organizojnë.
- ta njohin natyrën dhe të veprojnë me përgjegjësi ndaj saj.

Pfadis-tët organizojnë, sa të jetë e mundur, vet aktivitetet e tyre që i përgjigjet moshës së tyre.



## Aktivitetet tona

Qoftë në qytet apo fshat, qoftë brenda apo jashtë, veprimtaritë tona janë të shumanshme, ashtu siç janë edhe vet interesat e fëmijëve dhe të rinjve:

- pushimet nën tenda apo pushimore, të jesh në udhëtim dhe të përjetosh aventura
- rreth zjarrit me biseduar, qeshur dhe kënduar
- me u shfrenuar, me luajtur, me zier, me bërë punëdore
- ngjitja lartë urave me litarë dhe ndërtimi i kasolleve

Në qendër qëndron jetesa në grup. Këtu thurën plane, lidhen shoqëri dhe thjeshtë bisedohet për gjithçka, çfarë dikë e preokupon. Fëmijët më së shumti takohen të shtunën pasdite. Kulmi i vitit të skautëve arrihet me kampim të përbashkët gjatë pushimeve verore.

## Grup moshat e ndryshme

**Kastorët – “Biber”** (5-7 vjeç)

**Ujqërit – “Wölflin”** (6-11 vjeç)

**“Pfadis”** (10-15 vjeç)

**“Pios”** (14-17 vjeç)

### Udhëheqëset dhe udhëheqësit

(së paku prej 17 vjeç)

Udhëheqëset dhe udhëheqësit e rinj do të përgatiten qysh herët për përmbushjen e detyrave të tyre. Përgatitja dhe arsimimi i mëtejshëm i tyre arrihet në bashkëpunim me organizatat profesionale (të rinisë + sportit).

### Pfadi Trotz Allem (PTA), Skaut Përkundër Gjithave:

PTA qëndron i hapur për fëmijë dhe të rinj me një të metë fizike, psikike apo të shumëfishtë dhe ju mundëson atyre që përmes aktiviteteve të ndryshme plotë fantazi të i përjetojnë aftësitë dhe zgjuarsitë e tyre. Natyrisht që gjatë kësaj nuk do të mungon as kënaqësia.

## Shpenzimet

Për çdo vit rreth 70.- Franga. Shtesë vinë shpenzimet për aktivitetet si kampime dhe ekskursione dhe për pajisje speciale (këmisha Pfadi, çanta e shpinës etj.).

